



SHOQATA KOMBETARE TRANSPORTIT QYTETAS

Tiranë më, 18/02/2022

Lënda: Kërkesë për zbatimin e propozimeve të bashkërenduara me Shoqatën Kombëtare të Transportit Qytetas dhe marrjen e masave ligjore.

Drejtuar: Shkëlqesisë së Tij **Z. Edi RAMA**
Kryeministër i Republikës së Shqipërisë

Z. Erion VELIAJ
Bashkia Tiranë – Kryetar

Z. Arben AHMETAJ
Zëvendëskryeministër

Znj. Delina IBRAHIMAJ
Ministër i Financave dhe Ekonomisë

Znj. Belinda BALLUKU
Ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë

Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje

Të nderuar!

Shërbimi i transportit qytetës (urban) të udhëtarëve, në vendin tonë, që prej 20 viteve, kryhet nga subjekte private, të licensuara nga bashkitë përkatëse. Në këndvështrimin e funksionimit të tyre, si biznese, këto subjekte, të ardhurat për realizimin e këtij shërbimi i sigurojnë vetëm nëpërmjet tarifave që paguajnë drejtpërdrejtë udhëtarët që përdorin këtë lloj shërbimi. Operatorët privat që kryejnë



SHOQATA KOMBETARE TRANSPORTIT QYTETAS

këtë lloj shërbimi janë të bashkuar në Shoqatën Kombëtare të Transportit Qytetas (SHKTQ), e cila në vazhdim dëshiron edhe një herë të ngrejë shqetësimet që ndeshen dhe që përcaktojnë vazhdimësinë e këtij biznesi. Në muajt e fundit çmimi i naftës është rritur në nivele alarmante. Ndikimi kësaj rritje është në kostot e secilit operator, ku pamundësia për blerjen e saj në kohë, sjell një shërbim jo cilësor, vonesa në ofrimin e shërbimit dhe njëkohësisht kjo do sjellë edhe ulje të kërkesës së përgjithshme.

Sektori i transportit është shumë intensiv në veprimtarinë e tij dhe për këtë arsye ndikimi i çmimeve më të larta të naftës dhe derivative të saj, i përkthyer në çmime më të larta të karburantit është i rëndësishëm dhe thelbësor për veprimtarinë tonë dhe ndikon drejtpërdrejt në aftësinë për kryerjen dhe ofrimin e shërbimit për qytetarët. Nga shoqata jonë janë ngritur një sërë propozimesh të rakorduara dhe me kryetarin e Bashkisë Tiranë Z.Veliaj, si Bashkia me aktivitetin më të madh të transportit, mbi disa lehtësi të domosdoshme për sektorin tonë, pa të cilat shërbimi që ne ofrojmë do të shkojë drejt mbylljes si arsye e pamundësisë financiare.

Për të mbështetur kërkesën tonë ju sqarojmë se në koston e shërbimit tonë, rreth 48% vjen nga karburanti dhe derivatet e tij ku në muajt e fundit janë rritur me të paktën 25%. Këtë rritje ne e kemi të pamundur ta reflektojmë në cmim, ashtu sic llogjikisht e bën çdo biznes tjetër, përderisa cmimi i shërbimit tonë është i përcaktuar me Vendim të Këshillit Bashkiak.

Sot, për të bërë të mundur vazhdimin e shërbimit, pa cënuar cilësinë e tij, e cila është jetike për qytetet tona, ju sjell në kujtesë propozimet tona kundrejt qeverisë qendrore dhe asaj lokale në ndihmë të sektorit tonë, të cilat pavarësisht se janë rakorduar, pranuar dhe premtuar se do të realizohen, ende nuk shihet asnjë veprim konkret mbi to dhe ato janë si më poshtë:



SHOQATA KOMBETARE TRANSPORTIT QYTETAS

1. Rimbursimi i TVSH në shitje
2. Heqja e akcizës **37 lekë/litër**
3. Heqja e taksës së qarkullimit në karburant për subjektet e licensuara që ushtrojnë aktivitetin në transportin urban (qytetës) **27 lekë/litër**
4. Rimbursimi nga Ministritë e linjës lidhur me kategoritë (*Invalidë pune, Të verbër, Paraplegjik, Tetraplegjik, Studentët*) të cilët përfitojnë cmim të reduktuar ose falas, referuar dispozitave të Ligjit Nr.37/2014 “Për disa shtesa në Ligjin 8308 dt.18/03/1998 për Transportet Rrugore” të ndryshuar, për zgjidhjen e kësaj çështje.

Në mungesë të marrjes së masave, shoqëritë e transportit qytetës, me datë **1 Mars 2022** do të ndërpresin aktivitetin e tyre duke mos ofruar shërbimin qytetarëve. Kërkesat kanë qënë të shumta ashtu sikurse edhe premtimet për veprim dhe zgjidhje, por për sa kohë fenomeni vazhdon të mbetet i njëjtë dhe nuk ka asnjë marrje mase apo ndihmë kundrejt këtyre subjekteve, mosofrimi i shërbimit do të vazhdojë deri në momentin që këto kërkesa do të realizohen me veprime.

Theksojmë se marrja e masave si më mësipër nuk është në dëshirën e shoqërive tona, por të gjendura në pamundësi financiare të secilës prej tyre që ofrojnë këtë shërbim. Me bindjen që kërkesat tona janë të drejta dhe të realizueshme, mbetemi në pritje të një përgjigje pozitive nga ana Juaj.

Me respekt dhe konsideratë të lartë,

Rixhin QOSHJA

SH.K.T.Q - Kryetar
